



Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorëve të Pavarur

Komuna e Rahovecit

31 Dhjetor 2010

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i Auditorëve të Pavarur	3
Të përgjithëshme	7
Të gjeturat e vitit aktual	8
Të gjeturat e vitit paraprak	16
Forma të ndryshme të Opinioneve të Auditimit të përdorura nga Zyra e Auditorit Gjeneral në Raportin e Auditimit për vitin 2010	20
Pasqyrat Financiare për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010	23
Politikat kontabël	27

Raporti i Auditorëve të Pavarur

Për Kryetarin e Komunës Rahovec, Kosovë

Raporti mbi Pasqyrat Financiare

Ne kemi audituar pasqyrat përcjellëse financiare të Komunës së Rahovecit ("Komuna"), të cilat përfshijnë Pasqyrën e Pranimeve dhe Pagesave në para të gatshme për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010, Raportin e Ekzekutimit të Buxhetit, si dhe një përmbledhje të politikave më të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera sqaruese.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik ("SNKSP") Bazuar në Paranë e Gatshme *Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme* dhe me Udhëzimin Administrativ Nr. 16 /2010 mbi Raportimin Vjetor të Organizatave të Buxhetit dhe Udhëzimeve Administrative No. 15/2009, 18/2009, dhe për këtë menaxhmenti përcakton kontrollet e brendshme të nevojshme në mënyrë që të mundësojë përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Për shkak të çështjeve të përshkruara në paragrafët Baza për Mohim të Opinionit, ne nuk ishim në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit në mënyrë që të sigurojmë një bazë për opinion të auditimit.

Bazat për Mohim të Opinionit

1. Pasqyrat financiare të komunës për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010 në disa pjesë janë jo të plota dhe nuk barazohen me shënimet përkatëse në pasqyrat financiare. Prandaj, ne nuk ishim në gjendje për të marrë siguri të arsyeshme mbi përshtatshmërinë e informacionit financiar të dhënë në pasqyrat financiare të Komunës për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010.
2. Komuna nuk mban listë pagesash me palët e treta. Për shkak të natyrës së shënimeve të mbajtura në kontabilitet dhe sistemeve operative për pagesat nga palët e treta, si dhe mungesën e kontrolleve alternative të implementuara nga menaxhmenti, ne nuk ishim në gjendje të kryejmë teste të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit për të verifikuar plotësinë e pagesave nga palët e treta të njohura për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010.
3. Komuna nuk mban një regjistër të veçantë për pronën, impiantet dhe pajisjet e saj, por as regjistër në Sistemin Informativ Menaxhimit Financiar në Kosovë (SIMFK). Përveç kësaj nuk ka evidencë për kryerjen e numërimit fizik të mjeteve më 31 Dhjetor 2010 dhe nuk është bërë rakordim midis librave të Komunës me ndonjë numërimin fizik. Për më tepër, Komuna nuk ka përgatitur një listë të detajuar dhe gjithëpërfshirëse të pronave e pasurive të patundshme, duke përfshirë dokumentacionin e pronësisë të pronës së tillë dhe informacion në lidhje me statusin e regjistrimit

në emër të komunës në regjistrin lokal të Pasurive të Paluajtshme ose në Gjykatë.

Prandaj, ne nuk ishim në gjendje për të kënaqur veten tone me plotësinë dhe saktësinë e të dhënave financiare të komunës në lidhje me pronën, impiantet dhe pajisjet më 31 Dhjetor, 2010.

4. Më 31 Dhjetor 2010 Komuna nuk ka bërë shpalosjen e llogarive të arkëtueshme në lidhje mbi tatimin në pronë, taksave biznesore licencave, dhe taksave tjera të arkëtueshme të cilat janë të kërkuara të shpalosen sipas Instruksionit Administrativ 16/2010. Për më tepër Komuna nuk mbanë regjistrime të kompletuara të debitorëve. Prandaj ne nuk ishim në gjendje të sigurohemi me aplikimin e procedurave standarde dhe alternative me ekzistencën e llogarive të arkëtueshme më 31 Dhjetor 2010.
5. Bazuar në procedurat e kryera të auditimit ne identifikuam një numër mospërputhesh me Ligjin Nr 02/L-99, Rregulloren Nr.2007/20 e cila rrjedh nga Rregullorja e prokurimit 2003/17 "Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë" (i ndryshuar). Të tilla jo-pajtueshmëri kanë të bëjnë me procedurat e prokurimit të kërkuara të cilat nuk janë kryer dhe dokumentuar nga Komuna.

Mohim i Opinionit

Për shkak të rëndësisë së çështjes të përshkruara në paragrafin të Bazat për Mohim të Opinionit, ne nuk kemi qenë në gjendje të sigurojmë dëshmi të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit për të ofruar bazën për një opinion të auditimit. Prandaj, ne nuk shprehim një opinion mbi pasqyrat financiare.

Raport mbi Kërkesat të tjera Ligjore dhe Rregullative

Përveç auditimit tonë të pasqyrave financiare, një rishikim i përputhshmërisë ishte planifikuar dhe kryer për të shprehur një përfundim me siguri të kufizuar nëse, në të gjitha aspektet materiale, aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e pasqyruara në pasqyrat financiare janë në pajtim me autoritetet që qeverisin ato. Natyra, koha dhe niveli i punës së përputhshmërisë ishin të kufizuara në krahasim me atë të hartuar për të shprehur një opinion me siguri të arsyeshme mbi pasqyrat financiare.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një përfundim të bazuar në rishikimin tonë. Puna jonë është kryer në përputhje me ISSAI 4200 Udhëzime mbi Auditimin e Përputhshmërisë Lidhur me Auditimin e Pasqyrave Financiare. Këto parime kërkojnë që ne të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë rishikimin që të përfitojmë siguri të kufizuar nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni i pasqyruar në pasqyrat financiare janë në pajtim, në të gjitha aspektet materiale, me autoritetet që qeverisin ato.

Një rishikim është i kufizuar kryesisht në procedura analitike dhe pyetje, dhe për këtë arsye ofron më pak siguri se një auditim. Ne nuk kemi kryer një auditim, dhe për këtë arsye, ne shprehim konkluzionin tonë në formën e një sigurie të kufizuar, i cili është në përputhje me punën shumë të kufizuar që kemi kryer në këtë rishikim të përputhshmërisë.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për konkluzionet tona.

Konkluzion për përputhshmëri

Bazuar në punën tonë të përshkruar në këtë raport, aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare që kemi parë gjatë auditimit, janë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me autoritetet që i qeverisin ato.

Çështje të tjera

Ne tërheqim vëmendjen për si më poshtë:

- a) Burimi kryesor i besueshëm i informacionit për përgatitjen e pasqyrave financiare është **SIMFK**. Komuna nuk ka zbatuar një program të integruar kompjuterik kontabiliteti të brendshëm që do të siguronte informacionin për qëllime raportimi në kohë, të plotë dhe të saktë.
- b) Komuna nuk ka zbatuar një sistem gjithëpërfshirës dhe të automatizuar të faturimit dhe nuk mban lista apo llogari të veçanta e complete për të gjithë debitorët e saj në lidhje me taksat e ndryshme. Vetëm mbledhja e parasë së gatshme nga niveli i të hyrave regjistrohen. Të arkëtueshmet kërkohen të shpalosen në pasqyrat financiare por Komuna nuk i ka shpalosur në pasqyrat financiare të saj, më tej mungesa e saktësisë dhe tërësisë do të ndikojnë në të ardhurat që Komuna mund të fitojë dhe aftësinë për të përgatitur një buxhet të besueshëm dhe të saktë për të raportuar një normë të saktë të mbledhjes, si dhe monitorimin e mbledhjes së të ardhurave vetanake në kohën e duhur.
- c) Edhe pse Komuna mund të jetë e përfshirë në disa raste të vogla ligjore dhe është e mundshme që pagesa të parasë së gatshme të kërkohen në të ardhmen e afërt, Komuna nuk ka hartuar dhe zbatuar asnjë procedurë për informacion të plotë, të saktë dhe të besueshëm për regjistrimin e provizioneve dhe detyrimeve kontingjente.

Grant Thornton

Prishtinë,

01 Prill 2011

Shtojca I

Komuna e Rahovecit

Letër Menaxhmenti

Të përgjithshme

Auditim për 2010

Grant Thornton LLC është emëruar për të ushtruar auditimin e pasqyrave financiare vjetore të Komunës së Shtimes ("Komuna") të përgatitura në pajtueshmëri me bazë në para të gatshme SNKSP Raportimi Financiar në Para të Gatshme, për vitin që mbaron me 31 Dhjetor 2010.

Këshilla jonë në këtë dokument kufizohet në konkluzionet e specifikuar në vazhdim dhe e bazuar në plotësinë dhe saktësinë e fakteve të paraqitura më poshtë, supozimeve dhe prezantimeve. Nëse ndonjë prej fakteve, supozimeve apo prezantimeve të përmendura nuk është tërësisht i kompletuar apo i saktë, atëherë është e domosdoshme që ne të informohemi menjëherë, duke qenë se pasaktësia dhe mungesa e plotësisë mund të kenë një efekt material në konkluzionet tona. Për dhënien e këshillës sonë, ne jemi duke u mbështetur në dispozitat relevante të legjislacionit aktual në Kosovë, rregullave dhe interpretimeve juridike dhe administrative të saj. Këto autoritete i nënshtrohen ndryshimeve, në mënyrë retroaktive dhe/apo prospektive dhe ndryshime të tilla mund të kenë ndikim në vlefshmërinë e konkluzioneve tona. Ne nuk do të përditësojmë këshillat tona për ndryshimet ose modifikimet e mëvonshme të legjislacionit dhe rregulloreve, ose të interpretimeve juridike apo administrative të tyre.

Pasoja

Ky raport është dizajnuar të përfshijë rekomandime të dobishme që mund të ndihmojnë në përmirësimin e politikave të kontabilitetit dhe sistemit të kontrollit dhe kontabilitetit të Komunës si dhe në shmangien e dobësive që mund të çojnë në humbje materiale ose në gabime. Është detyrimi juaj të ndërmerri veprimet e nevojshme për korrigjimin e këtyre dobësive dhe në qoftë se ju dështoni të bëni një gjë të tillë, ne nuk do të mbajmë përgjegjësi për humbjet apo gabimet që mund të ndodhin si rezultat.

Përfshirja e masës

Siç kemi rënë dakord, ju gjithashtu keni pranuar që për arsye të rëndësishme në punën tonë të informacionit dhe përfaqësimeve që na janë dhënë nga Komuna, drejtuesit e saj, punonjësit apo agjentët, përveç rasteve të neglizhencës, keqbesimit ose pakujdesive të paramenduara, nuk do të na quani përgjegjës ose fajtorë për ndonjë humbje ose të tjera pasoja në qoftë se informacioni i rëndësishëm për punën tonë na është mbajtur apo fshehur me qëllim, ose na është paraqitur në mënyrë mashtruese.

Struktura e këtij raporti

Çdo kategori e vëzhgimeve është përshkruar në një faqe të veçantë. Për secilin vëzhgim struktura është: të gjeturat, risku, rekomandimi dhe komentet e Menaxhmentit.

Të gjeturat e vitit aktual

1 Përgatitja e pasqyrave financiare

Të gjeturat

Burimi kryesor i besueshëm i informacionit për përgatitjen e pasqyrave financiare është SIMFK Bilanci. Edhe pse të dhënat e Komunës ,arkëtimet dhe pagesat janë të gjeneruara në programin e kontabilitetit në nivel lokal në Access, ky sistem nuk është përdorur për të përgatitur të gjitha shënimet dhe shpalosjet në pasqyrat financiare.

Megjithëse Kryetari e kishte nënshkruar Deklaratën lidhur me prezantimin e pasqyrave financiare, Komuna nuk kishte përgatitur një draft të pasqyrave financiare në gjuhë serbe. Megjithatë, Komuna nuk ishte në gjendje të japë një version përfundimtar të pasqyrave financiare në gjuhën serbe deri në fund të auditimit tonë.

Për më tepër, informacioni i mëposhtëm i cili është i nevojshëm të shpaloset në pasqyrat financiare nuk është regjistruar në SIMFK dhe nuk është pjesë e një programi të integruar të kontabilitetit:

- Pagesat nga palët e treta,
- Prona, impiantet dhe pajisjet,
- Fatura të papaguara (detyrimeve)
- Fatura të papaguara (arkëtueshmeve).

Edhe pse Komuna mund të jetë e përfshirë në çështje të vogla gjyqësore dhe është e mundur që të ketë dalje të parasë në të ardhmen e afërt, Komuna nuk ka ndonjë procedurë formale që do të siguronte informacion të plotë, të përshtatshëm dhe të besueshëm për të regjistruar provizionet dhe detyrimet kontingjente.

Si pasojë e mangësive të lartpërmendura, shënimet si në vijim mungojnë ose nuk janë paraqitur siç duhet në pasqyrat financiare:

- Në pasqyrat financiare të Komunës, Neni 15 shënimi 27 – Përmbledhja e pasurive jo financiare në pronësi të organizatës buxhetore nuk është paraqitur si duhet;
- Në pasqyrat financiare të Komunës, Neni 15 shënimi 28 – Të arkëtueshmet nuk janë shpalosur.
- Në pasqyrat financiare të Komunës, Neni 16 shënimi 30 – Detyrimet kontingjente nuk janë shpalosur për vitet 2010, 2009 dhe 2008;
- Komuna nuk ka bërë asnjë shpalosje për shënimin nga 17 deri 23 si kërkohet.
- Në pasqyrat financiare të Komunës në shënimin 6 në linjën Mallra dhe Shërbime, avanset janë prezantuar me balanca negative në shumë prej 14 mijë Euro. Për më tepër, në shënimin 26 avanset e paarsyetuara nuk janë prezantuar si kërkohen nga neni 14.
- Në pasqyrat financiare të Komunës shënimet, Neni 9-Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në

- para, nuk rakordohet me shënimin 9 të pasqyrave financiare.
- Pranimet kapitale nga shitja e asetëve shpалosur në shënimin 14, nuk rakordon me raportin e ekzekutimit të buxhetit. Për më tepër nuk ka ndonjë shitje të asetëve gjatë 2010.
- Shënimi 25, pasqyra e faturave të papaguara (detyrimeve) përbëhet nga shuma e faturave të papaguara për çdo departament në vend që të shpалoset në detaje të kërkuara për çdo faturë të papaguar.
- Në pasqyrat financiare të Komunës shënimet, shënimi 12 – Të hyrat vetanake nuk rakordojnë me Raportin e Ekzekutimit të Buxhetit dhe Raportin e pranimeve sipas programeve.

Risku

Mangësitë në kontrollet e brendshme në lidhje me sistemin e raportimit financiar mund ta ekspozojnë Komunën ndaj rreziqeve dhe gabimeve si në vijim:

- Plotësia dhe saktësia e informacionit financiar;
- Integriteti i të dhënave;
- Ruajtja e pasurive; dhe
- Mungesa e regjistrimit të pagesave nga palë të treta mund të rezultojë në pasuri/shërbime të përdorura pa qera nga palë të tjera, të ndryshme nga Komuna.

Rekomandim

Përgatitja e pasqyrave financiare të Komunës duhet të përmbajë procedura dhe mjete të përcaktuara për të siguruar që informacioni i kërkuar është regjistruar, procesuar, përmbledhur dhe raportuar drejt në pasqyrat financiare.

Komentet e Menaxhmentit

Nuk ka komente

2 Menaxhimi i pronave, impianteve dhe pajisjeve

Të gjeturat

Komuna nuk ka procedura të dokumentuara dhe nuk mban një regjistër të veçantë për pronën e tij, impiantet dhe pajisjet, dhe regjistrin nga Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar në Kosovë (SIMFK). Për më tepër, Komuna nuk ka kryer numërimin vjetor dhe verifikimin e ekzistencës fizike të mjeteve më 31 Dhjetor 2010 e cila nuk është në përputhje me kërkesat e nr 21/2009 Udhëzimet Administrative mbi Menaxhimin e pronës Qeverisë.

Risku

Mos-ekzistenca e procedurave të përshtatshme dhe të politikës së regjistrit mund të çojnë në trajtim jo duhur të pasurisë për shkak të kufizimeve të vetvetishme në mjedisin e kontrollit.

Rekomandimi

Ne i rekomandojmë Komunës së Rahovecit të zhvilloj dhe të komunikojë një grup të politikave dhe procedurave në lidhje me pronën, ndërtesat dhe pajisjet. Menaxhmenti duhet të kryejë numërimin fizik dhe verifikimin e ekzistencës së të gjitha pasurive materiale të regjistruara në regjistrin e pronës, fabrikës dhe pajisjeve në baza vjetore. Artikujt e humbur duhet të hetohen dhe nëse është e nevojshme të çregjistrohen.

Përveç kësaj dhe si minimum, për regjistrat e lartpërmendur duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm për çdo pasuri fikse:

- Datën e përvetësimit
- Vendodhjen
- Numrin e specifikuar nga komuna (numër identifikues)
- Numrin rendor
- Përshkrimi dhe funksioni
- Kosto
- Detajet e zhvlerësimit, duke përfshirë metodat e llogaritjes si për qëllime të taksave po ashtu edhe për për qëllime financiare të raportimit
- Jeta e dobishme e parashikuar
- Koston e mirëmbajtjes pas datës së përvetësimit
- Data e nxjerrjes jashtë përdorimit
- Burimi i Financimit
- Numri i faturës për shpenzimin e bërë

Për më tepër, dhe për qëllim të ruajtjes së aseteve të saj në mënyrë të përshtatshme, duhet të kryejnë numërim fizik të rregullt dhe së paku vjetor, të gjithë pasurisë, pronave dhe pajisjeve. Regjistrimet kontabël përkatëse duhet të rakordohen me rezultatet e numërimit të tillë fizik.

Komentet e Menaxhmentit

Nuk ka komente

3 Të hyrat

Të gjeturat

Menaxhmenti i Komunës nuk ka shpalosur te arkëtueshmet me 31 Dhjetor 2010 në pasqyrat financiare.

Menaxhmenti i Komunës nuk ka shpalosur në detaje nën-llogaritë e borxhlinjve të saj në lidhje me tatimin në pronë. Pa të dhënat e mjaftueshme të hollësishme dhe të sakta të debitorëve, komuna nuk është në gjendje të përgatisë buxhetin në mënyrë të besueshme dhe të saktë, si dhe mbledhjen e të ardhurave vetanake në kohën e duhur. Si rezultat, nuk është e mundur për të kryer një rakordim të duhur apo analizë nga debitori.

Gjatë auditimit ne kemi vërejtur se nuk bëhet rakordim mujor me departamentet të cilat mbledhin të hyra vetanake si: Tatimit në pronë, të hyrave nga qiraja, Departamenti i Gjeodezisë, Urbanizmit etj, me Zyrtarin e mbledhjes së të hyrave vetanake i cili është përgjegjës të rakordojë dhe qartësojë nëse ka ndonjë diferencë që mund të rrjedh mes regjistrimeve në departamente dhe SIMFK-së.

Gjatë auditimit tonë ne kemi identifikuar që transaksionet nuk janë të regjistruara në SIMFK kur ato ndodhin p.sh. kur paguhen. Në vend të kësaj, transaksionet grupohen (për më shumë se një ditë) dhe si të tilla, të regjistruara në sistemin e SIMFK-së.

Në bazë të procedurave të auditimit të kryera, kemi identifikuar se kontrolli i brendshëm i Komunës i vendosur në lidhje me faturimin, grumbullimin dhe pajtimin e të hyrave nuk është dizajnuar në mënyrë të përshtatshme, veçanërisht në Departamentin e Shëndetësisë. Këto kontrole nuk veprojnë në mënyrë efektive në mënyrë që të japin siguri të arsyeshme mbi plotësinë e të hyrave të njohura për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010.

Gjatë auditimit ne kemi identifikuar që departamenti i të hyrave nuk ka të themeluar kontrole të brendshme dhe nuk kanë raportuar dhe arkëtuar llojet e ndryshme të të hyrave, si të hyrat nga parkimi për tre muajt e parë rresht.

Risku

Mangësia e saktësisë dhe plotësisë do të ndikojnë të ardhurat që Komuna mund të fitoj. Kontrollat e papërshtatshme dhe të pamjaftueshme në lidhje me të ardhurat dhe softuerë të papërshtatshme dhe sistemet e faturimit rrisin rrezikun e manipulimit të të dhënave dhe keqpërdorimit të informacionit. Një dobësi e tillë e sistemit mund të çojë në faturim jo të plotë dhe të ardhurat jo të plota. Regjistrimi manual dhe mungesa e ndërlidhjes së faturimit dhe sistemit të kontabilitetit ekspozon Komunën ndaj një risku shtesë për gabime. Përveç kësaj, ajo mund të jetë merr kohë dhe mund të krijojë shpenzimet shtesë për regjistrimin e të dhënave, rishikimin dhe përputhjen e informacionit.

Rekomandimi

Ne rekomandojmë që Komuna të ndërmarrë hapa për të përmirësuar sistemin e kontabilitetit dhe të faturimit në mënyrë që të sigurojë kontrole të sigurta, efikase dhe efektive në faturim dhe të hyra. Përmirësimi i procedurave të lidhura me sisteme të tilla do të mundësonte Menaxhmentit monitorimin dhe menaxhimin e rreziqeve të mëdha dhe sigurimin që vendimet në lidhje me buxhetimin, planifikimin dhe mbledhjen e të hyrave janë mbartur siç duhet. Ne i rekomandojmë Komunës që të bëjë:

-Implementimin e një sistemi të faturimit që përfshin detaje të përditësuara për pagesit, adresën e tyre të tanishme, historinë dhe normën e mbledhjes së të hyrave. Informatat e tilla duhet të jenë të mundshme vetëm për një numër të kufizuar të personave dhe me autorizimin e Menaxhmentit.

Te hyrat (vijon)

-Të vendosë dhe të kontrollojë tarifatat dhe normat e taksave në sistem në mënyrë qendrore, që të llogarisë dhe të gjenerojë automatikisht faturat. Ky gjenerim i faturave gjithashtu duhet të autorizohet dhe të rishikohet.

- Të ekzistojë një lidhje automatike midis të sistemit të faturimit dhe sistemit të kontabilitetit në mënyrë që informacioni të procesohet automatikisht në librin kryesor të kontabilitetit.

- Të ushtrojë rikonsilime të rregullta në mes të SIMFK-së dhe regjistrimeve në secilin departament baza të rregullta për të gjitha llojet e të hyrave. Çdo diferencë rikonsilimi duhet të hulumtohet dhe të zgjidhet brenda një afati të caktuar

- Të lidhen automatikisht zyra operative me atë të faturimit dhe të bëhen rikonsilime të rregullta në mes tyre, për rastet kur faturimi direkt lidhet me shërbimet nga zyra operative. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastet kur ekzekutohet një numër i madh transaksionesh.

Komentet e Menaxhmentit

Nuk ka komente

4 Shpenzimet

Pagat dhe mëditjet

Të gjeturat

Gjatë rishikimit të dosjeve të punëtorëve ne kemi hasur në disa dosje mungonte dokumentacioni i nevojshëm.

Në departamentin e shëndetësisë janë bërë rritje në pozita pa pasur kualifikime dhe dëshmi për aprovime të tilla.

Mallra dhe shërbime

Të gjeturat

Gjatë auditimit tonë, kemi identifikuar disa raste ku pagesat janë bërë pas më shumë se 30 ditësh pas datës së faturimit e cila nuk është në pajtueshmëri me provizionet e Direktivat e Thesarit dhe rregullën financiare 02 – Shpenzimet e parasë publike.

Bazuar në rezultatet e procedurave tona të auditimit kemi identifikuar deficite në dizajnimin dhe zbatimin e kontrollit të brendshëm lidhur me autorizimin e Rregullit të Pagesës së Detyrimit Financiar nga Nëpunësi Vërtetues. Gjithashtu kemi vërejtur disa shpenzime të udhëtimit të regjistruara në drejtorinë e Shëndetësisë – kujdesi primar jo të mbështetura me rregull të udhëtimit.

Gjatë auditimit tonë kemi identifikuar që Komuna nuk ka ndjekur provizionet e Marrëveshjes Memorandum të nënshkruar në mes të Komunës, KEK-ut dhe Qendrës së Distribucionit të Ujit më 01 Shtator 2010. Sipas këtij Memorandumi, Komuna ishte e obliguar të zgjidh detyrimet e saj për shpenzime të elektricitetit bazuar në faturat mujore. Përkundrazi, Komuna ka zgjidhur këto detyrime me pagesa në shumë të madhe. Ne nuk kemi qenë në gjendje të koordinojmë vlerat e paguara me faturat e ndërlidhura.

Nga Arsimi, Inspekcioni, Departamenti i komuniteteve është bërë pagesë për zyrën e komuniteteve për realizimin e shpenzimit “Budva 2010”, për më tepër nuk ka ndonjë dëshmi mbështetëse për udhëtimin në Budva, si fleta e thirrjes, agjenda, kush ka participuar dhe raporti i projektit.

Pagesa për shërbime private mjekësore është kryer me avansin e marrë për udhëtim zyrtar më 19 Nëntor 2010. Nuk ka ndonjë raport për udhëtim zyrtar apo ndonjë dokumentacion mbështetës që ky avans i marrë është për qëllime zyrtare.

Gjatë auditimi ne kemi identifikuar se Komuna ka bërë pagesa Shoqatës së Doktorëve të Kosovës edhe pse kontrata ka skaduar, si dhe gjithashtu nuk ka të zhvilluara procedura tenderimi për përzgjedhjen e këtyre shërbimeve.

Procedurat e prokurimit

Të gjeturat

Gjatë procedurave të prokurimit, Komuna nuk ka përdorë formën standarde të kontratave që janë pjesë e dokumenteve ofertuese dhe që mbyllin të gjitha termet e nevojshme të përgjithshme dhe speciale të kontratës. Forma standarde e kontratës është Pjesa B e dosjes së tenderit për mallra dhe shërbime.

Ne kemi identifikuar disa shpenzime të njohura si kategori mallra dhe shërbime, ku shpenzimi për to është bërë nga kategori tjera me kode tjera ekonomike si subvencione dhe transfere, apo investime kapitale. Si shembull blerja e kripës industriale është paguar nga kod i investimeve kapitale-Blerja e veturës, Prokurimi nr. 138 136.

Shpenzimet (vijon)

Gjatë inspektimit tonë të dokumentacionit burimor lidhur me procedurën e tenderit për projektet: Mirëmbajtja dhe shtruarja me zhavorr në rrugët e fshatit Zoqisht Reti, në rrugët e fshatit Qifllak dhe Opterush, dhe rrugët Agim Qelaj me numër prokurimi 123 136; 124 136; 125 136 ne kemi identifikuar se për projektet Qifllak dhe Opterush është paguar shuma më e madhe sesa është në marrëveshje. Për më tepër fituesit e projektit Mirëmbajtja dhe shtruarja me zhavorr në rrugët e fshatit Zoqisht Reti, në rrugët e fshatit Qifllak dhe Opterush ishin kompani të ndryshme, por fletëdërgesat ishin të njëjta në të dy projektet me numra të njëjtë, data të njëjta, metër kub të njëjta.

Gjatë inspektimit tonë të dokumentacionit burimor lidhur me procedurën e tenderit për projektet: Ndërtimit gropës për ujërat e zeza në rrugën “Strana”, Rahovec me nr. ID 623 10 051 521; Drafti i planit të zhvillimit të Komunës së Rahovecit me Nr. ID 623 10 010 221; Shërbime konsulente projekti me nr. ID 623 10 008 321; Furnizim me zhavorr për rrugë vendore në Komunën e Rahovecit me nr. ID 623 10 032 121 dhe Ndërtimi i Lapidarit “Xhelal Hajda” në Rahovec me nr. ID 623 10 024 521, Ndërtimi i trotuareve me ID No 057 121, Ndërtimi i trotuareve në rrugët A.Bugari dhe M.Isma me ID No 058 521, Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Dabidol, Qifllak, Kramovik, Petkoviç dhe Polluzhe me ID Nr. 100 511 ne kemi identifikuar parregullsitë në vijim:

-Në të gjitha projektet e theksuara më lartë, Komuna nuk ka kërkuar ekzekutim të garancisë të punëve që nuk është në përputhshmëri me provizionet e nenit 60 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). Për më tepër, ne gjithashtu kemi identifikuar që Komuna nuk ka zbatuar kërkesat e nenit 39 të LPP-së sipas të cilit Komuna është e obliguar të publikojë në gazetë ditore emrin e ofertuesit të zgjedhur brenda dy ditëve biznesore kur është marrë vendimi.

-Në çështjet në vijim me nr. ID 623 10 051 521; 623 10 010 221 dhe 623 10 008 321 nuk ka dëshmi që ofertuesit dhe fituesi i kontratës kanë qenë të informuar siç duhet lidhur me vendimin e marrë i cili nuk është në përputhje me kërkesat seksionit 29 dhe 30 të Rregullës së Prokurimit Publik Pjesa B.

-Në ndërtimin e Lapidarit “Xhelal Hajda” në Rahovec me nr. ID 623 10 024 521, Komuna nuk e kishte bërë zotimin e fondeve sipas vlerës të kontratës në shumë prej 10,000 Euro para se të nënshkruhet kontrata. Gjithashtu, nuk kemi qenë të siguar me dëshmi në lidhje me pranimet teknike të projektit.

-Në tenderin me ID Nr 101 121 furnizim me Aparat RTG “X-REI” nuk ka dokumentacion mbështetës për anulimin e tenderit në dosje të tenderit dhe informacioni se kompanitë që kanë aplikuar janë njoftuar.

Tutje, në përputhje me nenin 34 të Rregullave të Prokurimit Publik, Pjesa B, Rregullorja e Prokurimit Publik, provizionet e seksionit 29.2 – 29.4, 29.6 – 29.7 dhe 29.9 të kësaj rregulloreje do duhej të zbatoheshin në mënyrën e njëjtë për ekzaminimin dhe vlerësimin e kërkesave për të participuar në procedurë. Kandidatët që kanë kaluar testin e Seksioneve 29.3 dhe 29.4 të kësaj rregulloreje duhet të konsiderohen të para-kualifikuar dhe të zgjedhur për të pranuar një ftesë për tender. Komuna nuk ka zbatuar format standarde E2 dhe E7 të kërkuara nga kjo rregullore në projektin e ndërtimit të gropës së ujërave të zeza në rrugën “Strana”, në Rahovec me nr. ID623 10 051 521.

Subvencionet dhe transferet

Të gjeturat

Gjatë inspektimit tonë të dokumentacionit burimor kemi hasur se me 23 Dhjetor 2010 është bërë pagesë direkte tek arkatari i Komunës në shumë prej 7,810 Euro të cilat duhej të ju shpërndaheshin personave me nevoja ekonomike. Për më tepër, nuk na është ofruar dëshmi bindëse për këtë shpenzim. Shënimet për familjet me nevoja të veçanta janë marrë nga shërbimet sociale në shumë prej 2,870 Euro janë shpërndarë. Pjesa tjetër është shpërndarë sipas aprovimit të Kryetarit.

Shpenzimet (vijon)

Rreziku

Mungesa e komunikimit në kohë dhe miratimet nga autoritetet ose dokumentacion jo i plotë në dosjen e prokurimit mund të çojnë në mos-pajtueshmërinë me Ligjet ose kërkesave ligjore në fuqi.

Rekomandimi

Komuna duhet të vendosin procedura të mjaftueshme adekuate të kontrollit për monitorimin efektiv mbi përputhje me ligjet e aplikueshme dhe rregulloret, sidomos kërkesat e Ligjit mbi Prokurimin Publik (LPP).

Komentet e Menaxhmentit

Nuk ka komente

5 Auditimi i brendshëm

Të gjeturat

Komuna nuk ka krijuar një Komitet Auditimi.

Rreziku

Mungesa e një Komiteti Auditimi dhe mos-zbatimi i planit të auditimit, rrit rrezikun e dështimit të kontrolleve të brendshme. Përveç kësaj, nuk lejon që funksionet të cilat mbulohen zakonisht nga një Komitet Auditimi të kryhen me pavarësinë e duhur.

Rekomandim

Ne rekomandojmë që Kryetari i Komunës të sigurojë që Komuna do të konsiderojë krijimin e një Komiteti Auditimi me anëtarë që kanë eksperiencë relevante me raportimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Komiteti i Auditimit duhet të vendosë politika dhe procedura të duhura për të siguruar një standard të lartë të udhëheqjes së entitetit. Komiteti i Auditimit duhet të rishikojë statusin aktual dhe të propozojë veprime për përmirësime në sa më poshtë:

- Kontabiliteti dhe proceset e raportimit financiar të Komunës;
- Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm të implementuara nga Menaxhmenti;
- Proceset e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm;
- Përputhshmëria, raportimi dhe strukturat e kontrollit në gjithë Komunën të tilla që sigurojnë përputhje me kërkesat financiare dhe ligjore;

Komentet e Menaxhmentit

Nuk ka komente

Të gjeturat e vitit paraprak

1 Përgatitja e pasqyrave financiare

Të gjeturat

Burimi kryesor i besueshëm i informacionit për përgatitjen e pasqyrave financiare është SIMFK . Edhe pse të dhënat e Komunës ,arkëtimet dhe pagesat janë të gjeneruara në programin e kontabilitetit në nivel lokal në Access, ky sistem nuk është përdorur për të përgatitur të gjitha shënimet dhe shpalosjet në pasqyrat financiare.

Megjithëse Kryetari e kishte nënshkruar Deklaratën lidhur me prezantimin e pasqyrave financiare, Komuna nuk kishte përgatitur një draft të pasqyrave financiare në gjuhë serbe. Megjithatë, Komuna nuk ishte në gjendje të japë një version përfundimtar të pasqyrave financiare në gjuhën serbe deri në fund të auditimit tonë.

Për më tepër, informacioni i mëposhtëm i cili është i nevojshëm të shpaloset në pasqyrat financiare nuk është regjistruar në SIMFK dhe nuk është pjesë e një programi të integruar të kontabilitetit:

- Pagesat nga palët e treta,
- Prona, ndërtesat dhe pajisjet.
- Fatura të papaguara (detyrimeve).

Edhe pse Komuna mund të jetë e përfshirë në disa çështje të vogla gjyqësore dhe është e mundur që të ketë dalje të parasë në të ardhmen e afërt, Komuna nuk ka ndonjë procedurë formale që do të siguronte informacion të plotë, të përshtatshëm dhe të besueshëm për të regjistruar provizionet dhe detyrimet kontingjente

Si rrjedhojë e mangësive të lartpërmendura, shënimet si në vijim mungojnë ose nuk janë paraqitur siç duhet në pasqyrat financiare:

- Në pasqyrat financiare të komunës, Neni 15 shënim 27 - Përmbledhje e asetëve jo-financiare në pronësi të organizatës buxhetore nuk është shpalosur për vitet 2008 dhe 2007 ;
- Në pasqyrat financiare të Komunës, Seksioni 16 shënim 29 – Detyrimet Kontingjente nuk është i shpalosur për vitet 2009, 2008 dhe 2007;
- Në shpalosjet e pasqyrave financiare të Komunës Neni 9-Pasqyra e Pranimeve dhe Pagesave, shënim 6 nuk rakordon me shënimin 6-Mallra dhe Shërbime të pasqyrave financiare, për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2007.
- Në shpalosjet e pasqyrave financiare të Komunës, Neni 9 - Pasqyra e Pranimit dhe Pagesave në Para të gatshme, shënim 3 nuk rakordon me shënimin 3 për vitet që përfunduan më 31 Dhjetor 2007 dhe 2008.
- Në shpalosjet e pasqyrave financiare të Komunës, Neni 9 - Pasqyra e Pranimit dhe Pagesave në Para të gatshme, shënim 9 nuk rakordon me shënimin 9 të pasqyrave financiare, për vitet që mbyllet më 31 Dhjetor, 2009, 2008, 2007.

- Shënim 25, Deklarata e faturave të papaguara (detyrimeve) përbëhet nga shuma e faturave të papaguara për çdo departament në vend që të shpaloset në detaje të kërkuara për çdo faturë të papaguar.
- Në shpalosjet e pasqyrave financiare , shënimi 12- Të hyrat vetanake nuk rakordojnë me Raportin e pranimeve sipas programeve.

2 Menaxhimi i pronës, impianteve dhe pajisjeve

Të gjeturat

Komuna nuk ka procedura të dokumentuara dhe nuk mban një regjistër të veçantë për pronën e tij, impiantet dhe pajisjet. Për më tepër, Komuna nuk ka kryer numërimin vjetore dhe verifikimin e ekzistencës fizike të mjeteve më 31 Dhjetor 2009 dhe nuk ka rakorduar librat e saj me regjistrimin nga numërimi fizik i cili nuk është në përputhje me kërkesat e nr 21/2009 Udhëzimet Administrative mbi Menaxhimin e pronës Qeverisë

3 Të hyrat

Të gjeturat

Menaxhmenti i Komunës nuk i ka klasifikuar si duhet të hyrat gjatë vitit në Sistemin e SIMFK sipas kodit të tyre ekonomik sipas udhëzimit administrativ 20/2009

Menaxhmenti i komunës nuk mban kartela të ndara të debitorëve të saj në lidhje me taksat të ndryshme të tilla si: tatimi vjetor për Biznes Licenca, qira për shfrytëzimin e komunës etj pronë sipas Udhëzimit Administrativ 20/2009. Pa të dhënat e mjaftueshme të hollësishme dhe të sakta të debitorëve, komuna nuk është në gjendje të përgatisë buxhetin në mënyrë të besueshme dhe të saktë, si dhe mbledhjen e të ardhurave vetanake në kohën e duhur. Si rrjedhim, me përjashtim të taksave mbi pronën, Thesari dhe Komuna nuk janë të pajisur me listë të detajuar të prodhuar nga sistemi i kontabilitetit ose sistemin e faturimit. Si rezultat, nuk është e mundur për të kryer një rakordim i të duhur apo analizë nga debitori.

Në bazë të procedurave të auditimit të kryera, kemi identifikuar se kontrolli i brendshëm i Komunës i vendosur në lidhje me faturimin, grumbullimin dhe pajtimin e të hyrave nuk është projektuar në mënyrë të përshtatshme. Këto kontrolle nuk veprojnë në mënyrë efektive në mënyrë që të japin siguri të arsyeshme mbi plotësinë e të hyrave të njohura për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009.

4 Shpenzimet

Të gjeturat

Gjatë testimeve tona të shpenzimeve në departamentin e "Kulturës, Rinisë dhe Sportit" shpenzime për promovime në stadiumin e qytetit me CPO 90772 dhe 107714 nuk u dha kontrata për faturat përkatëse me nr 49/09 me një shumë prej 930 euro dhe 3.435 Euro

Procedurat e prokurimit

Të gjeturat

Gjatë inspektimit tonë të dokumentacionit burimor në lidhje me procedurën e tenderit të aplikuar për ndërtimin e rrugëve, ndërtimin e shkollës fillore, riparimin e qytetit muze, riparimin e dritat e trafikut etj, ne kemi identifikuar parregullsi të caktuara.

-Në gjashtë raste përkatësisht me ID no.623 09 032 521, 623 09 054 521, 623 09 075 521, 623 09 006 521, 623 09 044 521, 623 09 027 121 nuk ka "Pasqyrë të Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve “ i cili është në kundërshtim nenin 8,1 dhe 8,5 të LPP, sipas nenit kjo deklaratë duhet të jenë të përgatitur para fillimit secilin aktivitet të prokurimit

- Në tre raste respektivisht me ID nr. 623 09 043 521, 623 09 058 521, 623 09 044 521 vlerësimet e tenderit nuk ka filluar në përputhje me nenin 29,15 për Prokurimin Publik në Pjesën B Rregullores, i cili thotë se procesi i vlerësimit duhet të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderit dhe nuk më vonë se 96 orë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderit (secili anëtar i komisionit të vlerësimit të vlerësimit duhet të nënshkruajnë deklaratën nën betim).

